



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Study program

Menaxhimi profesional me logjistikë dhe zinxhir të furnizimit

Fakulteti	Biznesi dhe Ekonomia
Cikli i studimeve	Cikli i dytë (Pasdiplomike)
SETK	60
Kodi	N-SPEC-PLSCHM
Titulli	Specialist i menaxhimit profesional me logjistikë dhe zinxhir të furnizimit
Numri në arkiv i akreditimit [60]	03-2080/1
Vendimi për fillim me punë	03-1619/14 (10.11.2017)
Data akreditimit	14.07.2017

Përshkrimi i programit

Ky program paraqet një program studimor profesional në logjistikë dhe menaxhim të zinxhirit të furnizimit, shprehje që nënkuptojnë integrimin e proceseve kyçe biznesore nga shfrytëzuesi i fundit përmes furnitorëve për shkak të shtimit të vlerës së firmës, anëtarëvetë saj kryesorë të logjistikës dhe zinxhirit të furnizimit, për përfshirje të klientëve dhe palëve tjera të interesuara.

Ky program studimor profesional paraqet kornizë për logjistikë dhe menaxhim të zinxhirit të furnizimit, e cila kërkon integrim ndër-funksional të proceseve kyçe biznesore në kuadër të firmës dhe gjithë rrjetit të firmave. Programin studimor profesional bazohet edhe në rastet studimore praktike dhe praktikë në kompanitë që operojnë në fushën e logjistikës dhe menaxhimit të zinxhirit të furnizimit, nga perspektiva menaxheriale dhe paraqet koncepte në një format të dobishëm për marrjen e vendimeve.

Nocionet, konceptet dhe parimet themelore janë analizuar në raport me faktin se si lidhen dhe përputhen ato mes vetes në kuadër të firmës dhe në logjistikë e menaxhim të zinxhirit të furnizimit. Praktika e studimet e rastit janë marrë nga kompanitë dhe aplikimet e tyre korporative të këtyre koncepteve që të tregohet se si mund të implementohet në logjistikë dhe në menaxhimin e zinxhirit të furnizimit.

Logjistika dhe menaxhimi i suksesshëm i zinxhirit të furnizimit kërkon integrim ndër-funksional të proceseve themelore biznesore në kuadër të firmës dhe në tërë rrjetin e firmave të cilat e përbëjnë logjistikën dhe zinxhirin e furnizimit. Sfidat këtu është se përmes studimeve dhe praktikave të rastit në kompanitë të vërtetohet se si në mënyrë të suksesshme të arrihet deri te ky integrim. Identifikohet dallimi mes logjistikës dhe menaxhimit të zinxhirit të furnizimit dhe paraqitet korniza për logjistikë dhe menaxhim të zinxhirit të furnizimit. Sesioni klasor do t'i kushtohet secilit prej proceseve të logjistikës dhe menaxhimit të zinxhirit të furnizimit, si dhe temave si: komponentat udhëheqëse të logjistikës, menaxhimi i zinxhirit të furnizimit, lidhja elektronike, integrimi i strategjive të logjistikës dhe zinxhirit të furnizimit në strategjinë korporative, mapimi i logjistikës dhe zinxhirit të furnizimeve, planifikimi i depos dhe distribuimit, zhvillimi dhe implementimj i partneriteteve në logjistikën vendore dhe ndërkombëtare dhe në proceset e zinxhirit të furnizimit dhe implementimi i logjistikës dhe menaxhimit të zinxhirit të furnizimit.

Karriera

Programi studimor u mundëson studentëve të pajisen me njohuri teorike dhe praktike për ballafaqim të suksesshëm me çështjet të ndryshme lidhur me logjistikën dhe menaxhimin e zinxhirit të furnizimit. Mes tjerash ky program përfshin fitimin e shkathtësive të botës reale të cilat janë të aplikueshme në rolet e tashme dhe të ardhshme. Diploma në logjistikë dhe menaxhim me zinxhirin e furnizimit ofron mundësi për rritje vertikale. Studentët do të fitojnë kompetenca profesionale në këtë fushë e cila do të shpi në përmirësim të shkathtësive të tyre të punës. Pas mbarimit të studimeve studentët do të mund të punësohen në organizata të ndryshme biznesore që merren me tregti, transport, shpediton dhe të ngjashme

Rezultatet e të mësuarit

Njohuritë dhe të kuptuarit

Studentët do të demonstrojnë kuptim të plotë të strukturës dhe qarkullimit të brendshëm të logjistikës dhe menaxhimit të zinxhirit të furnizimit të bizneseve dhe ndërmarrjeve të cilat mund të jenë nga biznese të vogla e deri në ato multi-nacionale. Ata do të jenë në gjendje ta kuptojnë edhe marrëdhënien mes organizatës dhe mjedisit ekonomik e tregut të jashtëm. Në këtë mënyrë, studentët do të arrijnë të kuptojnë se si vendimet menaxheriale do të kenë efekt në aktorët relevant të interesuar (stakeholders) si brenda firmës ashtu edhe jashtë saj.

Aplikimi i njohurive dhe të kuptuarit

Studentët do të jenë në gjendje t'i integrojnë dhe t'i aplikojnë mjetet dhe teknikat e biznes logjistikës dhe zinxhirit të furnizimit, dhe duke u thirrur në njohjen e gjërë të funksioneve kryesore të biznesit (menaxhimi i strategjisë, kontabiliteti, llogaritja, financa, marketingu, menaxhim i operacioneve, sistemet informative) për analizë dhe zgjidhje të problemeve të komplikuar biznesore në logjistikë dhe zinxhir të furnizimit dhe të merren vendime që do të kenë efekte pozitive në firmë.

Aftësitë për të vlerësuar

Studentët do të jenë në gjendje të bëjnë vlerësim mbi bazë të njohurive të tyre të thelluara të mjeteve analitike biznesore bashkëkohore dhe përsiatja kritike e problemeve të logjistikës dhe zinxhirit të furnizimit nga këndvështrime të ndryshme.

Aftësitë e komunikimit

Studentët do të jenë në gjendje të demonstrojnë shkathtësi mikro-sociale, shkathtësi të lidershit dhe shkathtësi prezantuese për nevojat për suksese gjatë gjithë jetës në karrierë. Këto pasqyrojnë vlerësim, komunikim, prezantim efikas, si dhe bashkëpunim në kuadër të organizatës.

Aftësitë e të mësuarit

Aftësi për njohje të nevojave personale për dije dhe aftësi të mëtutjeshme për veprim të pavarur gjatë përfitimit të dijeve dhe shkathtësive të reja në kornizat shoqërore; gjithashtu studenti do të fitojë aftësi për marrje të përgjegjësisë për zhvillim dhe formim të mëtutjeshëm profesional.

Lista e lëndëve

Semestri 1

- [SPSM-0101] [6.0 SETK] **Zhvillimi organizativ dhe rritja**
- [SPSM-0102] [6.0 SETK] **Menaxhimi i logjistikës**
- [SPSM-0103] [6.0 SETK] **Marketing - Menaxhmenti**
- [4.0 SETK] **Lëndë zgjedhore Изборен предмет Elective course**
- [4.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [4.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**

Semestri 2

- [SPSM-0201] [6.0 SETK] **Kontabiliteti financiar**

- [SPSM-0202] [6.0 SETK] **Menaxhimi i zinxhirit të furnizimeve**
- [SPSM-0204] [6.0 SETK] **Menaxhimi i cilësisë dhe performanca**
- [4.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [4.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**
- [4.0 SETK] **Lëndë zgjedhore**

Description of courses

Lëndë obligative

- **Zhvillimi organizativ dhe rritja**

Qëllimet e lëndës: T'i përgatisë studentët me teorinë themelore të rritjes dhe zhvillimit si dhe me mënyrën e "ballafaqimit" me ta për zbatimin më efektiv në sistem. Theksi gjithashtu do të vendoset në organizimin dhe funksionimin e institucioneve të sistemit ekonomik të cilat janë përgjegjëse për rritjen dhe politikave zhvillimore. Mënyra e funksionimit efikas dhe efektiv e këtyre institucioneve në hartimin e politikave të rritjes dhe zhvillimit si dhe në zbatimin e tyre e monitorimin e efekteve të tyre për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit.

- **Menaxhimi i logjistikës**

Me miratimin e njohurive që kjo lëndë ofron, studentët: - do ta kuptojnë përcaktimin konceptuale, domethënien dhe përmbajtjen e logjistikës dhe menaxhimit të zinxhirit të furnizimit; - do t'i zbatojnë njohuritë e fituara; - do t'i indentifikojnë elementet kryesore të menaxhimit të zinxhirit të furnizimit dhe lidhshmërinë e tyre me zinxhirët e krijimit të vlerës së shtuar në prodhimtari dhe në rrjetat e vlerave; - do të përdorin potencialet e sistemeve informative për përkrahje në menaxhimin e zinxhirit të furnizimit dhe zinxhirit të krijimit të vlerës shtesë në prodhimtari; - do të kuptojnë metodat e parashikimit dhe do t'i aplikojnë ato gjatë parashikimit të kërkesës; - do t'i njohin dhe do t'i aplikojnë metodat e menaxhimit të inventarit dhe prokurimit.

- **Marketing - Menaxhmenti**

Lënda në fjalë do t'i përgatisë studentët t'i përdorin dhe t'i menaxhojnë 4 P-të në një organizatë ose kompani, ashtu që të jenë në gjendje t'i dizajnojnë elementet optimale të marketingut etj. si produktin, çmimet, promocionin dhe metodat e shpërndarjes me të cilat ballafaqohen kompanitë. Si zgjidhje e rëndësishme marketingu përfshin një analizë të kujdesshme të situatës, përdorimin inteligjent të hulumtimit si dhe parimet e marketingut. Qëllimi i lëndës është të arrihet të kuptohet kompleksiteti i vendimeve në marketing menaxhment, si në kuadër të analizës së tregjeve, klientëve, konkurrencës ashtu edhe në integrimin e koncepteve me planin fillestar të marketingut.

- **Kontabiliteti financiar**

Lënda do t'u mundësojë studentëve zhvillim të shkathtësive të veçanta për aplikim adekuat në njohurive teorike të kontabilitetit financiar përmes softuerit aplikativ në pajtueshmëri me ligjin për kontabilitet dhe standardet e kontabilitetit të cilat janë në fuqi në legjislacionin e Maqedonisë. Lënda gjithashtu do mundësojë trajnim të studentëve për një aplikim të theksuar të softuerit për kontabilitet si një pajisje ndihmëse për udhëheqjen e evidencës financiare të kontabilitetit tek subjektet mikro, të vogla dhe të mesme biznesore në Republikën e Maqedonisë. Përgatitja e të gjitha dokumenteve financiare dhe materiale të nevojshme në aktivitetin e përditshëm biznesor të subjekteve, përpilimi i shpejtë i raporteve financiare si dhe finalizimi i llogarive vjetore të SHT për nevojat e brendshme dhe atyre të klientëve, të Regjistrisë qendrore dhe DAP-it në RM. Studentët me këtë lëndë fitojnë mundësi që të jenë më afër vetëpunësimit përmes krijimit të zyrës së tyre të kontabilitetit ose të udhëheqim kontabilitetit financiar të bizneseve të tyre familjare. Realizimi i këtyre qëllimeve i rrit atributet e studentëve dhe i bën ato më konkurrues në tregun e punës.

- **Menaxhimi i zinxhirit të furnizimeve**

Qëllimet e lëndës: Studentët do të fitojnë njohuri për tërë procesin e menaxhimit të zinxhirit të furnizimit, duke filluar nga lënda e parë e deri te produkti final; analizë të situatave konkrete logjistike, diagnostifikimi i problemeve në zinxhirin e furnizimit dhe ofrimi i zgjidhjeve alternative për zgjidhjet për trajtim të këtyre problemeve; aplikimi i modelit SCOR; indentifikimi i elementeve kryesore të menaxhimit të zinxhirit të furnizimit dhe lidhjes së tyre me zinxhirin e krijimit të vlerës së shtuar në prodhimtari dhe rrjetet e vlerës; aplikimi i teknologjive informative për integrim dhe menaxhim me logjistikën; ndërveprim mes internetit dhe menaxhimit të zinxhirit të furnizimit.

- **Menaxhimi i cilësisë dhe performanca**

Qëllimet e lëndës: - Të dihen bazat e menaxhimit të cilësisë; - Përcaktimi i metodave statistikore të menaxhimit të cilësisë; - Aftësimi për përdorim të metodave për menaxhim të cilësisë, si dhe analizimi dhe zgjidhja e problemeve në organizatë; - Identifikimi i teknikave për menaxhim të cilësisë; - Metoda për matjen e performancës; - Shpërblime për

performanca më të mira.

Lëndë zgjedhore

- **Tregtia ndërkombëtare**

Qëllimi i kësaj lëndë është t'u mundësojë studentëve të fitojnë njohuri më të thelluara në fushën e tregtisë ndërkombëtare dhe shkathtësi specifike për aplikim të këtyre njohurive në praktikë. Për realizim të këtyre qëllimeve, kjo lëndë i përpunon aspektet teorike të kësaj fushe, duke u fokusuar edhe në implementimin praktik të tyre. Studentët duhet të jenë në gjendje: - T'i dallojnë instrumentet sasiore, cilësore dhe të përziera të sistemit të tregtisë së jashtme si dhe thelbin e tyre; - Ta dinë esencën e instrumenteve të sistemit devizor dhe bazat e politikës së kursit devizor; - Ta njohin sistemin e tregtisë së jashtme dhe atij devizor të Republikës së Maqedonisë; - Të jenë të aftë t'i analizojnë efektet të cilat i kanë sistemi aktual i tregtisë së jashtme dhe ai devizor mbi këmbimin e jashtëm tregtar dhe mbi bilancin e pagesave të Republikës së Maqedonisë.

- **Blerja dhe menaxhimi i inventarit**

Qëllimet e lëndës: Të aftësohen studentët ta njohin rëndësinë e blerjes si një pjesë e tërësisë së organizatave bashkëkohore biznesore. Të aftësohen studentët t'i njohin qasjet për negociata gjatë sjelljes së vendimeve për blerje. Të fitojnë studentët njohuri të thelluara në fushën e menaxhimit të inventarit. Të fitojnë studentët njohuri të thelluara rreth metodave dhe teknikave të zakonshme për menaxhim me inventarin.

- **Planifikimi dhe menaxhimi i depove dhe qendrave të shpërndarjes**

Qëllimet e lëndës janë: - të ofrohet një pasqyrë dhe një kuptim i thelluar i kanaleve të marketingut; - të ekspozohet në teknikat e marketingut për identifikimin dhe punën në problemet e lidhura me kanalet e shpërndarjes; - studentët ta kuptojnë procesin e magazinimit të inventarit dhe magazinimit; - të kuptohet procesi i porositjes, përpunimit si dhe procesi i prokurimit.

- **Punë praktike**

Qëllimi i kësaj lënde është t'u ofrojë studentëve mundësinë e marrjes së eksperiencës nga kompanitë e fushave përkatëse dhe të mësojnë si të punojnë me detyra që kërkojnë njohuri të fituara gjatë studimeve teorike. Kjo do t'u mundësojë studentëve: • T'i kuptojnë operacionet ditore të përfshira në bizneset; • T'i aplikojnë në praktikë vlerat, njohuritë dhe konceptet e fituara gjatë programit akademik; • Të fitojnë kuptim të mjediseve shoqërore dhe fizike në të cilën bizneset operojnë; • Të përvetësojnë shkathtësi dhe kompetenca në mbledhjen dhe analizën e informacionit, komunikimit të shkruar dhe gojor, shkathtësi ndërpersonale dhe personale.

- **Ndërmarrësia dhe menaxhimi i inovacionit**

Qëllimi i mësimi të kësaj lënde është që t'u ndihmojë studentëve për ta kuptuar rëndësinë dhe esencën, funksionimin dhe organizimin e ndërmarrësisë dhe inovacioneve në ekonomi dhe menaxhimin e tyre të suksesshëm gjatë procesit zhvillimor. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet procesit të ndërmarrësisë, llojeve të ndërmarrësisë dhe perspektivave në ndërmarrësi, si dhe rëndësisë së kreativitetit, shpikjes dhe rishtarisë në zhvillimin e ndërmarrjeve.

- **Menaxhmenti i burimeve njerëzore**

Qëllimi i lëndës është t'i njoftojë studentët me problematikën e ndërlikuar të administrimit të burimeve njerëzore. Kjo problematikë e kuptuar si proces i realizimit të disa aktiviteteve dhe funksioneve ka peshë për njerëzit se, si burime më të rëndësishme në organizatë, ata shfrytëzohen në mënyrë më efikase dhe më efektive. Në këto suaza, vëmendje e posaçme u kushtohet aktiviteteve vijuese të menaxhimit të burimeve njerëzore: konceptet e ndryshme të menaxhimit të burimeve njerëzore, përmbajtja, qëllimet dhe detyrat e menaxhimit të burimeve njerëzore në funksionimin e organizatës, analizës së punës, planifikimit të burimeve njerëzore, sigurimit të kandidatëve për vende të reja pune, përzgjedhjes së burimeve njerëzore, zhvillimit profesional të burimeve njerëzore, nxitjes së suksesit në punë, zbulimit të potencialit dhe aftësive të menaxhimit, menaxhimit të burimeve njerëzore dhe marrëdhënieve të punës.